



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.669/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), me panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Kamenicë, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me objekt të çështjes keqpërdorim i votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 20.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e palejuar ankesa Anr.669/2021 e datës 18.10.2021, e paraqitur nga Jona Arifi, kandidate për Kuvend Komunal në Komunën e Kamenicës nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Kamenicë, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave për shkak të keqpërdorimit të votave për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 18.10.2021, ka pranuar një ankesë Anr.669/2021 nga Jona Arifi, kandidate për Kuvend Komunal në Komunën e Kamenicës nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Kamenicë me të cilën pretendon se në vendvotimet 1024D/01R, 1024D/04D, 1024D/03R dhe 1024D/02R në Koretin dhe në vendvotimet 1001X/04R, 1001X/03R, 1001X/02R, 1026/d/03D në Kamenicë, 1009D/03R, 1009D/01R dhe 1009D/02R në Roganë ka parregullsi në procesin e votimit dhe mungesë të votave ngase sipas të njëjtës në këto vendvotime ka familjar dhe miq të ngushtë të cilët janë të bindur se e kanë votuar dhe madje disa prej tyre kanë ardhur nga jashtë shtetit për ta përkrahur. Andaj përmes ankesës së parashtruar kërkon rinumërim të votave në këto vendvotime. Ankesës i ka bashkangjitur ID të personave që është e bindur se e kanë votuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduar në ankesë përkitazi me parregullsitë, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankueses. Hudhja e ankesës së Jona Arifit, kandidatë për Kuvend Komunal në Komunën e Kamenicës nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) nuk e paragjykon çështjen dhe ankueses nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.669/2021 më datën 20.10.2021



Kryesuesi i Panelit
Ferki Xhaferi

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*